


BIBLIOTEKA

8SH-1
V27

VARGJE
TË
ZGJEDHURA



891.985-1
v 27

S

Vargje tē zgjedhura

(BOTIM JUBILAR)

14475
~~55059.~~

BOTIERA E SHTËPIËS
FESTIM I 20 VJETËRË

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Botohet me rastin 25 vjetorit të themelimit të Lidhjes
së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë.

FSHATI ZBARDH...

Fshati zbardh majë malit, mes pyjesh,
Si brilant mes së gjelbrës kurorë;
Verës ai ndrin nën dritëra yjesh,
Dimrit ndrin nën reflekse dëbore.

Janë të reja shtëpitë, orenditë,
Dhe ndërgjegjet, mendimet e zemrat...
Mes së resë, kandilët, të mpitë,
Ngjajnë si përbindsha, mes foshnjesh të ëmbla

Përmbi fshatin në mal, në çdo skutë
Po montojnë telat tonë elektriqe,
Dhe gjithë fshati ngjan kështu si lahutë,
Që këndon kohën tonë heroike!

DRINI I BARDHË PËR SHOKUN ENVER

Me dallgë përplot n'shpërthim stuhish,
Kur rreptë buças ndër gryka e shpella,
Kur fryhem det, plot gjire e dredha,
Kur trandet dheu përmes rrafshinash,
Kur ma kush s'matet me mue n'Atdhe,
Unë jam i vogël — i madh Ti je.

Unë jam i thellë pash e litar,
Ku si n'pasqyrë del rrugëllimi,
Plot male e fusha, kah m'qet shtegtimi,
Plejni tue da për rrugë të mbarë,
Çdo pune qoftë i jep një shtjellë,
— N'urtësinë e kohës Ti je ma i thellë.

Unë jam dhe trim, kisha me thanë,
Shpatën me nxjerrë, me ngajt' me kalë,
Me da bejleg dhe gjak me falë,
Kaçak ndër male prita me zanë,
Me mundë baloza, me rrëxue krajli,
— Por Ti, qe, besa, ma shkon n'trimni.

Ti besë ke rrrokë me komunizmin,
Me krah Skënderi shekullin p'e çan,
Nji gjurmë si t'shkambit n'ballë ia ndan,
Tradhëtinë e mposht — revizionizmin;
Unë, Drini, rrjedh si trim atij shpati,
Fjalën ta ruej, Drini asht gati.

PARA BUSTIT TË SELAM MUSAIT

(*Baladë*)

Koha hedh pa prerë
Përmbi festen tënde:
Dimri — flokë bore,
Vera — dritë hëne.

Dhe vijnë të mveshin,
Rreth duke t'u mbledhur,
Ndërsa ti në heshtje
Rri në bronx i derdhur.

Eh, gjithë këtë bronx
Gjallë ku ta gjeje,
Vetë do ta shkrije,
Plumba do ta bëje.

Rri... Po nuk të rrihet,
Ndaj të vijnë mornica.
... Vrapi yt po endet
«Poshtë nga Babica».

... Lugjesh në ato net
Zbrite si veri;
Prozhektorët ndiqnin
Sharkun tënd të zi.

Flaka nëpër duar
Me rrëmbim të futej;
Gjalmi mbi dyfek
Dridhej mos këpuntej.

Plumbatë në xhepe
(Gjetur breg pas bregu),
Me thërrime misri
Hynin te dyfeku;

Dhe kërcisnin egër
Plumbat tanë të rrallë,
Se kish shpirto misri
Dhe desh gjak në ballë.

Malet nëpër mjergull
Sa i zgjoi pushka,
Kafshatën e gojës
Varën poshtë mbi mushka.

«Bukë pér lirinë,
Moj kasolle t'errëta;»
Dhe u drodhën kapistrat
Nga mushkat e serta.

«Bjeruni, o burrani!
Hop... t'i zëmë së gjalli!»
Dhëmbët nga urejtja
Krisnin si stërralli.

Kështu e pësofsh
Hasmi rrënjjëdalë:
Kufomat përposh,
Pëndët përmbi valë.

Deti sa të pa,
Kur në qafë dole,
Të thirri si nëna,
Ti si djalë i fole;

Dhe vërviti valët,
Sa të pa te shtegu,
Të të mirr' te gjiri,
Të të sill' te bregu.

Vlora krahëlidhur
Ç'vrull të dha te gjuri;
Malua nga ballkoni
Të tundte flamurin.

Ndaj ti, si i dehur,
Rrugën poshtë e more...
Po ç'kish aq shumë tela,
Ç'kish aq shumë llogore!